



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 06, datë 17.01.2022

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “M.C INERTE LUMZI” SH.P.K., PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, pikat 1, 2 dhe 3, nenit 16, pika 1 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; nenit 15 dhe 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat të ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.01.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 164/7 prot., datë 10.01.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “M.C INERTE LUMZI” sh.p.k. për rinovimin e licencës nr. 358, seria T17P, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 13, datë 19.01.2017”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “M.C INERTE LUMZI” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 358, Seria T17P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendim të bordit të ERE-s nr. 13, datë 19.01.2017, me afat 5-vjeçar. Kjo licencë përfundon më datë 19.01.2022.
- Me shkresën nr. 1014 prot., datë 19.10.2021, ERE ka njoftuar shoqërinë se në rast interesi nga ana e saj për rinovimin e licencës me të cilën është pajisur, duhet të paraqesë aplikimin përkatës jo më vonë se 2 (dy) muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (brenda datës 19.11.2021).
- Shoqëria “M.C INERTE LUMZI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1014/1 prot., datë 30.12.2021 ka depozituar një dokumentacion të konsiderueshëm bashkëlidhur aplikimit të saj për rinovim të licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, por ky aplikim nuk është paraqitur në afat, bazuar te përcaktimet e nenit 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.

- Në mbështetje të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, shoqëria mund të paraqesë një aplikim të ri për licencim brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të ERE-s për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit dhe dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për aplikimin mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm edhe për aplikimin e ri, i cili duhet të përmbajë bashkëlidhur dhe pagesën e diferencës që përkon me aplikimin për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “M.C INERTE LUMZI” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 13, datë 19.01.2017.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI